



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 19 maj 2023

Gjuha: Anglisht

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Shkurtimin e Afateve në lidhje me Kërkesën e Mbrojtësit të
Viktimave për Ndryshimin e Masave Mbrojtëse (F00514)**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së të Akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) lëshon këtë urdhër për shkurtimin e afateve në lidhje me kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për ndryshimin e masave mbrojtëse (F00514).

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 17 maj 2023, Mbrojtësi i Viktimave dorëzoi një kërkesë për ndryshimin e masave mbrojtëse në fuqi për viktimat V01/04, V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04. Synimi i kësaj kërkesë ishte udhëzimi i ekspertit për vlerësimin e dëmeve materiale që viktimat pretendojnë të kenë pasur, dhe si rrjedhojë të përgatisë një raport (Kërkesa).¹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

2. Trupi Gjykues mbështetet në nenet 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 9(5)(a), 76 dhe 116(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

III. ANALIZË

3. Trupi Gjykues vëren se, në pajtim me rregullën 76 të Rregullores, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe Mbrojtja e Pjetër Shalës (Mbrojtja) kanë të drejtë të kthejnë përgjigje ndaj Kërkesës, nëse dëshirojnë, brenda dhjetë (10) ditësh

¹ KSC-BC-2020-04, F00514, Mbrojtësi i Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtësit të Viktimave për Ndryshimin e Masave Mbrojtëse për Lejimin e Nxjerrjes së Informacionit për Ekspertin në lidhje me Vlerësimin e Dëmit Material*, 17 maj 2023, publik, para 5, 11.

nga dorëzimi i saj dhe Mbrojtësi i Viktimave mund të kundërpërgjigjet brenda pesë (5) ditësh nga dorëzimi i përgjigjes (përgjigjeve), nëse do të ketë.

4. Duke mbajtur parasysh fushëveprimin relativisht të kufizuar të Kërkesës dhe në interes të një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme, në pajtim me rregullën 9(5)(a) të rregullores, të shkurtojë *proprio motu* afatet për përgjigjet dhe kundërpërgjigjet siç përcaktohet nga rregulla 76 e Rregullores.

IV. VENDIM

5. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses:
- a. **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen të kthejnë përgjigje ndaj Kërkesës, nëse dëshirojnë, brenda **të martës, 23 maj 2023, në orën 16:00**; dhe
 - b. **URDHËRON** Mbrojtësin e Viktimave të kundërpërgjigjet, nëse dëshiron, brenda **të mërkurës, 24 maj 2023, në orën 16:00**.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Kryegjykatëse

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Zhilber Biti

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Roland Dekers

E premte, 19 maj 2023

Në Hagë, Holandë.